

LIGJ
Nr.7717, datë 2.6.1993

PËR DISA NDRYSHIME NË KODIN E PROCEDURËS PENALE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese" dhe të ligjit nr.7692, datë 31.3.1993 "Për një shtesë në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991", me propozim të Këshilli të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.6069, datë 25.12.1979 "Për Kodin e Procedurës Penale" bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Neni 9-a ndryshohet si vijon:

"Avokati merr pjesë në hetimet paraprake, që nga momenti i ndalimit, arrestimit apo i paraqitjes së personit të thirrur për t'u marrë në përgjegjësi penale".

Neni 2

Neni 10 ndryshohet si vijon:

"Të pandehurit i sigurohet mbrojtje me avokat. Kur ai nuk ka mjete të mjaftueshme, prokurori dhe gjykata detyrohet t'i sigurojnë mbrojtjen falas duke i caktuar kryesisht një avokat.

Pjesëmarrja e avokatit është e detyrueshme dhe sigurohet nga prokurori dhe gjykata kur:

a) I pandehuri është i mitur;

b) i pandehuri për shkak të të metave fizike a psikike, nuk mund të realizojë vetë të drejtën e mbrojtjes.

Në këto raste heqja dorë nga mbrojtja është e pavlefshme".

Neni 3

Në nenin 14 paragrafi i dytë ndryshohet si vijon:

"Avokati ka të drejtë të komunikojë lirisht dhe privatisht me të ndaluarin, të arrestuarin apo të pandehurin, të njoftohet paraprakisht për kryerjen e veprimeve hetimore ku është i pranishëm i pandehuri dhe të marrë pjesë në to, t'u drejtojë pyetje të pandehurit dhe dëshmitarëve, të njihet me të gjithë materialin e çështjes në përfundim të hetimeve".

Neni 4

Në nenin 68 fjalja e parë ndryshohet si vijon:

"Organet e prokurorisë, organet e rendit publik dhe për ushtarakët komandat e reparteve, kanë të drejtë të ndalojnë personin, për të cilin ka të dhëna të mjaftueshme se ka kryer një vepër penale që dënohet me heqjen e lirisë, vetëm në rastet kur:".

Neni 5

Neni 70 ndryshohet si vijon:

"Organi që kryen ndalimin ka për detyrë të njoftojë menjë herë prokurorin, i cili brenda 24 orëve nga momenti i ndalimit, vendos, sipas rastit, lirimin e të ndaluarit ose paraqitjen e çështjes tek gjyqtari për vlerësim.

Gjyqtari, kur konstaton se ndalimi është i pabazuar, vendos lirin e të ndaluarit. Ndalimi nuk mund të vazhdojë më tepër se 48 orë".

Neni 6

Neni 76 ndryshohet si vijon:

"I pandehuri vihet në dijeni menjëherë dhe hollësisht për akuzën që i bëhet. Atij i njoftohet e drejta që ka për të bërë deponime rreth akuzës dhe, kur e kërkon, i jepet koha e nevojshme për t'u përgatitur.

I pandehuri ka të drejtë të mos japë shpjegime për akuzën që i bëhet".

Neni 7

Neni 85 ndryshon si vijon:

"Kontrolli i banesës mund të bëhet vetëm me vendim të gjyqtarit, me përjashtim të rasteve kur duhet shmangur një rrezik i atypëratyshëm për jetën dhe shëndetin e njerëzve, për pasurinë ose kur është në kryerje e sipër një krim ose menjëherë pas kryerjes së tij".

Neni 8

Neni 87 ndryshohet si vijon:

"Sekuestrimi i korrespondencës ose i çdo mjeti tjetër të komunikimit privat mund të bëhet vetëm me vendim të gjyqtarit dhe gjithmonë në prani të përfaqësuesit të zyrës përkatëse".

Neni 9

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.571, datë 26.6.1993 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.